LIGJ
Nr.9259, datë 15.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8932, DATË 26.7.2002 "PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT"

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 fjalët "një togë e Batalionit Special Komando" zëvendësohen me fjalët "një nënrepart i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, së bashku me elementet mbështetëse".

Neni 2

Në nenin 2 fjalët "të togës" zëvendësohen me fjalët "të nënrepartit".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4282, datë 26.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu